

Republika e Shqiperise
Gjykata Administrative e Shkalles se Pare
K O R Ç E

Nr(390)-00257 Regj.Them
Data e regj. 24.02.2016

Nr 484-(189) Vendimi
Data 10.05.2016

V E N D I M
“Ne emer te Republikes”

Gjykata administrative e shkalles se pare Korçe e perbere prej:

Kryetare e seances gjyqesore - **ETLEVA GJAMO**

asistuar nga sekretare e seances gjyqesore Safjola Sadik ne Gjykate, ne date 10.05.2016 ora 8 50 , mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore me dyer te hapura çeshtjen administrative me nr (390)-00257 rregjistri themeltar , date 24.02.2016 rregjistrimi qe i perket:

PADITES: Shoqeria “DAJANA” sh.p.k, me seli ne Ura e Mborjes, ruga Korçe –Mborje, perfaqesuar me autorizim Vasil Xega.

E PADITUR: Drejtoria Rajonale Tatimore Korce, perfaqesuar me autorizim nga juriste Mirela Veriga.

OBJEKTI: Shfuqizimin e aktit administrativ “Njoftim vleresimi per detyrimet tatimore” nr 17 574 date 04.11.2015.

BAZA LIGJORE: K.Pr.C, nenet 31, 32 dhe 154, Ligji 9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise” nenet 33, 37, 80, 81 etj, Udhezimi nr 24 date 02.09.2008, ligji 10279 date 20.05.2010, Udhezimi nr 16 date 03.05.2010”Per administrimin dhe dokumentimin e procedurave te pajisjeve fiskale”

Ne perfundim te gjykimit te zhvilluar ne prani te perfaqesuesit me autorizim te paditesit dhe ne prani te perfaqesueses me autorizim te pales se paditur, ne pretendimet perfundimtare te depozituara me shkrim, perfaqesuesi i paditesit kerkoi pranimin e padise, perfaqesuesja e pales se paditur rrezimin e padise.

Gjykata pasi shqyrtoi aktet dhe bisedoi çeshtjen ne teresi.

V E R E N

Nga aktet bashkangjitur kerkese padise ka rezultuar se shoqeria “DAJANA” eshte rregjistruar si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar prrej dates 16.02.2000 me objekt te veprimtarise “*Aktivitet tregetar i mallrave te ndryshme, aktivitet ne fushen e kafeterise, aktivitet te paketim ambalazhim te prodhimeve te veta, aktivitetin e prodhimit e tregetimit te embelsirave*” me perfaqesues ligjor Zoi Tarusha, me seli ne Rugen Korçe-Mborje, tek Ura e Mborjes.

Inspektoret e verifikimit ne teren ne daten 01.08.2015 kane ushtruar kontroll ne nje pike tregetimi embelsirash te ndodhur Korçe, Lagja nr 1, "Bulevard Republika" ku evidentohet fakti se ...subjekti disponon kase fiskale me nr .. gjate kontrollit rezultoi se subjekti nuk kishte leshuar kupon tatimor ne dy tavolina.

Mbi te dhenat e aktit te konstatimit, ne daten 01.08.2015 eshte mbajtur "Procesverbale gjobe" sipas te cilit :

- ne baze te nenit 122, pika 1, germa b) e ligjit nr 9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", subjekti eshte denuar me gjobe ne masen 200 000 leke, per mospërdorim te pajisjes fiskale.

Ne daten 03.09.2015 Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe ka nxjere "Njoftim vleresim per detyrimet tatimore" ku personit juridik "DAJANA" i kerkohet pagesa e gjobes sipas procesverbalit cituar me lart , njoftim i cili i eshte dërguar subjektit me shkresen nr 17 574 prot date 04.11.2015.

Pasi eshte vene ne dijeni te njoftim velresimit shoqeria ka ankimuar prane Drejtorise se Apelitimit Tatimor e cila me vendim nr 37 529/1 prot date 21.01.2016 la lene ne fuqi njoftim vlerësimit per detyrimet tatimore.

Ne daten 24.02.2016 shoqeria ka paraqitur ne gjykate padine objekt i ketij gjykimi me te cilen kerkon "Shfuqizimin e aktit administrativ "Njoftim vleresimi per detyrimet tatimore" nr 17754 date 04.11.2015.

Si ne padi dhe gjate gjykimit, paditesi ngre pretendimin se ne datën 01.08.2015 u ushtrua kontroll dhe ne aktet e mbajtura eshte pasqyruar fakti se nga subjekti nuk ishte leshuar kupon tatimor ne dy tavolina por grupi i kontrollit nuk identifikoi produktin e shërbyer pa kupon dhe as klientin qe kishte mare furnizimin pa kupon pasi nuk ka patur te tille. Ne baze te nenit 125 te ligjit 9920 date 19.05.2009 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise" bleresi i shërbimit pa kupton tatimor dënohet me gjobe ne masën 1000 leke nderkohe qe nuk eshte zbatuar penalitet. Ne aktin e konstatimit nuk evidentohet rethana e ofrimit te sherbimit dhe e qenies se klientit dhe punonjësit e shoqerise duke pare se veprimet e administratës tatimore ishin te pabazuara, refuzuan nenshkrimin e aktit te konstatimit. Ne te njejten date dhe ore nga DRT Korçe eshte ushtruar kontroll edhe ne adresën tjetër te ushtrimit te veprimtarisë ne Lagjen nr 7, "Bul Shengjerrigji" duke u mbajtur akt konstatimi per te njejten shkelje nderkohe qe procesverbali i gjobes nuk u mbajt ne vend por ne zyre duke e konsideruar me tej shkeljen e perseritur dhe dënuar subjektin me 300 000 leke gjobe. Ne kushtet e nje veprimtarie te qëllimshme te administratës tatimore per te penalizuar subjektin dhe ne kushtet kur veprimet janë ne kundërshtim me ligjin pasi nuk eshte kryer kundravajtja e mosleshimit te kuponit tatimor, njoftim vlerësimit per detyrimin tatimor gjobe duhet te shfuqizohet.

Perfaqesuesja e pales se paditur gjate gjykimit dhe ne perfundim te tij prapesoi se njoftim vleresimi per detyrimet tatimore ka dale mbi bazen e rezultateve te kontrollit te Inspektoreve te verifikimit ne teren te cilet ne zbatim te nenit 80.3 te ligjit 9920 date 19.05.2008 dhe Udhëzimit nr 24 date 02.09.2008 kryejne kontrole te befasishme, verifikime ne vendin e ushtrimit te aktivitetit me qellim zbulimin ne kohe te shkeljeve qe kane lidhje me rregjistrimin e personave te tatueshem, identifikimin e personave te paregjistruar, perdorimin e pajisjeve fiskale , me dokumentimin e mallrave ne ruajtje etj.

Ne nenin 55 te ligjit 9920 date 19.05.2008 parashikohet detyrimi i subjekteve per lëshimin e detyrueshëm te kuponit tatimor per regjistrimin e pagesave me para ne dore dhe ne vështrim te nenit 122, pika 1 germa b) nendendarja 1) parashikohet dënim me gjobe ne masën 200 000 leke per subjektet e regjistruar me TVSH dhe tatim fitimi ne rastet kur konstatohet shkelje e ligjit.

Edhe ne Udhezimin nr 16 date 03.05.2010 "Per administrimin dhe dokumentimin e procedurave te pajijes fiskale" parashikohet e drejta e inspektoreve per te kryer kontrole per lëshimin e kuponave tatimore dhe vendosjen e gjobave ne rast te konstatimit te shkeljeve.

Nga kontrolli i ushtruar ka rezultuar se subjekti nuk kishte leshuar kupon tatimor ne 2 tavolina dhe konstatimet e mesiperme jane kryer pas nje procedure te rregullt kontrolli , ne përputhje me përcaktimet e ligjit 10 279 date 20.05.2010 "Per kundravajtjet administrative" akti i konstatimit dhe proceseverbali i gjobes plotesoje elementet e nevojshem te nje akti, jane mbajtur ne vendin kryerjes se kundravajtjes , ne kohen e konstatimit te saj dhe ne prani te përfaqësuesit te subjektit i cili ka refuzuar te nneshkruaje aktin e konstatimit.

Ne baze te pikës 5 te nenit 108 te ligjit 9920 date 19.05.2008 dhe pikës 108.5 te Udhzimit nr 24 date 02.09.2008 pala paditëse e ka baren e proves per te provuar se njoftim vleresimi eshte i pasakte. Ne kushtet kur paditesi ka shkelur nje norme ligjore dhe kundravajtja eshte përcaktuar ne menyre te detajuar ne aktin e konstatimit, plotësohen elementet e kundravajtjes administrative dhe padia duhet te rezohet.

Gjykata pasi shqyrtoi pretendimet e paditesit , prapesimet e pales se paditur si dhe provat e sjella prrej tyre, bazuar edhe ne përcaktimet e nenit 16 te Kodit te Procedures Civile ne lidhje edhe me nenin 17/2 te ligjit 49/2012 çmon se padia e paditesit eshte plotesisht e bazuar ne ligj dhe ne prova dhe si e tille duhet te pranohet.

Ne rastin konkret gjykata çmon se konflikti i parashtruar per zgjidhje rrjedh nga nje procedim administrativ dhe per efekt te verifikimit te bazueshmerise ligjore te pretendimeve te paditesit, pervec ligjit te posaçem nr 9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise(i ndryshuar) ku gjejne rregullim ligjor shkeljet qe i atribohen paditesit, do te referoje edhe ne dispozitat e ligjit nr 10 279, date 20.05.2010 "Per kundravajtjet administrative" si dhe nenin 118 te Kodit te procedurave Administrative.

Paditesi e bazon padine e tij ne dispozita te ligjit te posaçem "Per procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" si dhe Udhezimit ne zbatim te tij, duke kerkuar shfuqizimin e aktit administrativ, njoftim vleresimit tatimor, i cili eshte akt administrativ me karakter individual qe prek drejtperdrejt te drejta te tij ne cilesine e tatimpaguesit .

Nga teresia e provave te shqyrtuara gjate gjykimit, gjykata konkludon se me te drejte nga paditesi kerkohet shfuqizimit i "Njoftim vleresimit" te detyrimit tatimor i lene ne fuqi nga Drejtoria e Apelimit Tatimor , pasi kemi te bejme me nje akt te pathemelte , pra te paligjshem per shkak se organi administrativ qe e ka nxjere ate nuk e ka vleresuar situaten faktike qe legjislacioni tatimor e kerkon si kusht per penalizim te subjektit, por ka konkluduar apriori se eshte kryer shkelje tatimore administrative.

Ne kete konkluzion gjykata arrin pas nje analize te hollesishme te dokumentacionit mbi bazen e te cilit eshte konkluduar per konsumim te elementeve te kundravajtjes tatimore administrative, e mandej eshte vendosur penalizimi me gjobe.

Si ne aktin e konstatimit ashtu edhe ne procesverbalin e denimit me gjobe eshte vendosur shenimi se tatimpaguesi ka refuzuar te firmose por nuk eshte evidentuar fakti se kopja e ketyre akteve i eshte dhene tatimpaguesit , edhe pse pala e paditur pretendon se eshte respektuar ligji 10 279 date 20.05.2010 "Per kundravajtjet administrative".

Megjithate Gjykata çmon se keto parregullsi ne ushtrimin e kontrollit, nuk jane kushtet determinante qe passjellin anullimin e aktit, por akti behet i anullueshem nga mungesa e provimit te elementeve materiale, te cilet jane vendosur ne themel te tij.

Nga shqyrtimi i "Aktit te konstatimit" rezulton se ai *permban te shprehur daten e kontrollit* si dhe faktin se *ne momentin e kontrollit subjekti nuk lëshon kupon tatimor ne 2 tavolina*, por nje rrethane e tille nuk gjen mbeshtje ne provat e shqyrtuara gjate gjykimit e per me teper nuk referon ne asnje te dhene konkrete lidhur me faktin nese ne momentin e kontrollit subjekti ka patur kliente ne këto tavolina te cileve tju kishte ofruar sherbim, me qellim qe kishte detyrimin per prerje te kuponit tatimor per çdo sherbim te ofruar.

Ne kuptim te nenit 80.3.c te Udhhezimit nr 24 date 02.09.2009 "Per procedurat tatimore ne Rpeubliken e Shqiperise" njihet e drejta e Inspektoreve te verifikimit ne teren per te kryer kontrole te llojit "Verifikime ne vend" te cilat synojne zbulimin ne kohe te shkeljeve qe kane lidhje nder te tjera edhe me perdorimin e pajisjeve fiskale ndersa ne parag e fundit te pikes 80.3 *parashikohet se ...procedurat teknike te detajuara per kryerjen e kontrollit tatimor percaktohen ne manualin e kontrollit tatimor.*

Ne piken 6 te ketij manuali qe i referohet procedurave qe ndiqen per kryerjen e verifikimeve nga sektori i verifikimit ne teren, *parashikohet se :*

Inspektorët e Sektorit të Verifikimit në Terren, për shkeljet e vërtetuara, kanë për detyrë t'ja komunikojnë tatimpaguesit, t'ia bëjnë të qartë atij shkeljen e konstatuar duke ju referuar aktit ligjor apo nënligjor dhe më pas të dokumentojnë rezultatet e punës së çdo verifikimi të kryer ne proces-verbal, akt-verifikimi etj, sipas modeleve bashkengjitur manualit. Për çdo verifikim, pavarësisht se vërtetohet ose jo shkelje, rezultati dokumentohet me akt konstatimi dhe, për çdo shkelje të vërtetuar mbahet proces-verbal sipas modelit bashkengjitur. Një kopje e proces-verbalit apo akt konstatimit i lihet subjektit.

Lidhur me verifikimin dhe kontrollin e dispozitave ligjore qe lidhen me pajisjet fiskale ne kete manual peraktohet se ..kur pajisja fiskale eshte e instaluar verifikohet nese leshohet kupon tatimor per çdo shitje te kryer.

Nderkohe Neni 122, pika 1, germa b) i ligjit "Per procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise "parashikon denimin e tatimpaguesit nese nuk lëshon kupon tatimor për qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve, për çdo rast konstatimi, pra vete dispozita kerkon qe te plotesohen njeherazi dy kushte :

- 1-te jete realizuar sherbimi apo te kete qarkulluar malli dhe*
- 2-tatimpaguesi te mos e kete shoqeruar me leshimin e nje kuponi tatimor.*

Ne kushtet kur ne aktin e konstatimit nuk evidentohet rrethana e realizimit faktik te sherbimit ndaj nje klienti apo ndaj disa klienteve(*pasi nuk permendet fare nese ne lokal ka*

patur te tille dhe nese po sa prrej tyre kishin perfituar shërbim ne këto dy tavolina), nuk ka se si te konkludohet per mosprerje te kuponit tatimor apo mosperdorim te kases fiskale.

Per te patur kundravajtje administrative ne kuptim te nenit 4 te ligjit nr 10 279, date 20.05.2010 "Per kundravajtjet adminisitrative", duhet qe te jete kryer shkelja me faj e dispozitave ligjore dhe nenligjore, te kryera me veprim ose mosveprim dhe per te cilat ligji parashikon denim administrativ.

Ne rastin konkret nga te dhenat e aktit te konstatimit i cili eshte pikenisja e penalizimit te tatimpaguesit, nuk konkludohet se ai ka shkelur me faj dispozitat ligjore me mosveprim, pasi nuk provohet se ai ka shkelur nenin 122, pika 1 germa b) te ligjit "Per procedurat tatimore", pra nuk vertetohet shkelja e atribuar. Ne kete rast ndodhemi para njerit prrej rasteve te pavlefshmerise relative, pasi permbajtja e aktit nuk perputhet me ligjin siç percaktohet ne nenin 118 te Kodit te procedurave Administrative.

Ne analize te sa me siper çmohet pranimi i padise sipas objektit te saj, duke anuluar aktin administrativ pa u shprehur per regullim pasojash pasi paditesi nuk ka parapaguar detyrimin tatimor me gjobe.

Persa i takon shpenzimeve gjyqesore te takses mbi aktet ne shumen 12 000 leke, parapaguar nga paditesi, konform nenit 106/1 te Kodit te Procedures Civile, i ngarkohen pales se paditur, meqenese çmohet pranimi i padise.

Ne veshtrim te nenit 45 germa a) te ligjit 49/2012 ky vendim eshte i paankimueshem pasi sipas kesaj dispozite.... nuk lejohet ankim ndaj vendimeve perfundimtare te gjykates administrative per padi me objekt kundershhtimin e denimit per kryerjen e kundravajtjeve administrative me vlere me te vogel se 20-fishi i pages minimale ne shkalle vendi. Ne baze te VKM nr. 573, datë 3.7.2013, "Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi", duke filluar nga muaji Korrik 2013 e ne vazhdim, paga bazë minimale mujore, për punonjësit në shkallë vendi, eshte 22.000 (njezet e dy mije) leke.

PER KETO ARSYE

Bazuar ne n/126 dhe 306 te K. Pr. Civile.

VENDOSA

-Pranimin e padise se paditesit Dajana "SH.P.K", pale e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe, duke u shfuqizuar "Njoftimi vleresimi i detyrimit tatimor qe përmban detyrimin gjobe ne masen 200 000 leke, date 03.09.2015 " si akt jo ne përputhje me ligjin.

-Shpenzimet gjyqesore te takses mbi aktet ne shumen 3 000 leke i ngarkohen te paditurit.

-Ky vendim eshte perfundimtar dhe kunder tij nuk lejohet ankim.

U shpall ne Korce date 10.05.2016 .

SEKRETARE
Safjola Sadik



GJYQTARE
ETLEVA GJAMO

